

IDAJET JAHAJ



*Vendime...*

POEZI

8SH-1  
71P

IDAJET JAHAJ

# MENDIMET



-Poëzi-

SHITEPIA BOTUESE "MONROE"  
Tiranë, 1994

---

Botohet nën kujdesin e Shoqatës Kulturore  
"ISMAIL QEMALI"

---

Redaktor: Bardhosh Gaçe  
Korrektor: Albert Abazi  
Kopertina: Safo Marko  
Recezent: Njazi Hamzarai

*Realizimi në*  
Kartëqjuri  
*Elois Themeli*

*Shlyfi Firma*  
**MONROE**

# Mesazhe poetike

Tanimë, mesazhet e para poetike të Idajet Jahajt i kemi në dorë, në vëllimin e tij poetik “Mendimet”. Në këtë vëllim poeti shpalos mesazhe të ngarkuara me gjësimin e historisë së vendlindjes, me peisazhin herë të blertë, herë të thepisur, me maja malesh të ngarkuara me dëborë, e diku gjatë harqe vetëtimash e portrete lebërish.

Mesazhet e poezisë së Idajet Jahajt vijnë si mbresa të fuqishme e të drejtpërdrejta nga jeta. Ato e nxitin autorin, të lerë në mes të udhës gjithçka të nisur më parë dhe të derdhë në vargje shpirtin e tij të gjerë poetik. Motive të tjera vijnë si ngacmim i një jehone të pashuar që papritur ndalon vrapin e muzës poetike për të deshifruar mesazhet që përcjell jehona. Meditimi poetik herë me varg të rregullt e melodioz e herë me varg të thyer zë vend të dukshëm në lëmin e parë poetik të autorit.

Duke lexuar poezinë e Idajet Jahajt, si “Mesapluku im”, “Peisazhi i vendlindjes”, “Perëndimi i diellit në Vlorë”, “Dëshirë”, “Babai”, “Një shtëpi”, “Çeta Plakë e Vlorës” hyjnë në krijimet më të mira të autorit, të cilat flasin me një gjuhë të bukur poetike.

Në vargjet e këtyre poezive, ashtu si edhe në disa të tjera, poeti shkrin natyrshëm peisazhin dhe trimërinë duke përcjellë bindshëm dhe me emocion mbresa e ngacmime që të bëjnë për vehte. Në këto motive, bukuria e vendlindjes, peisazhi i ashpër dhe i gjelbër, me dëborën dhe flladet e Çikës dhe të Çipinit të shtyjnë të mendosh për bukuritë e natyrës dhe të shpirtit të njerëzve të Lahërisë, të cilat janë të pranishme në çdo varg, në kadencat, ritmin dhe rimat e saj, duke gurgulluar në mënyrë polifonike në zërin poetik të Idajet Jahajt, ashtu siç ndodh edhe me këngën burrërore të fshatit të tij: "Qazimademçen" e mirënjohur.

Ky kuadër poetik bëhet edhe më i plotë kur Ajkuna dhe hëna kërkojnë Omerin, ndërsa luftëtarja Shote Galica "nusëron" mes luftrash krah burrit të saj.

Në disa vjersha të poetit, sidomos ato me motive lirike e intime: "Në takim të duarve", "Ajo vajzë", "Babai", "Lirikë", "Shkurtima", etj. puls i poetik rreh përmes vargjeve lakonik e befasues të cilat pohojnë se Idajet Jahaj në të ardhmen do të japë një profil edhe më të gjerë poetik.

Poezia e Idajet Jahajt është e çiltër dhe e freskët. Ajo i flet kohës sonë me sinqeritetin e vet, me mendimin e thellë e artistik.

*Ibrahim Gani*

# Mbijetesë

E shtypën shekujt po s'u shua,  
E tkurrën kohërat po s'u dha.  
I shkuan flakët s'u shkumbua;  
I fryu murlani po s'u tha!

Në dimrat mijëvjeçarë,  
Në palcën thellë ruajti farë,  
E, si Feniks i vërtetë,  
lulëzoi nga palca e vet...

Komb Feniks i vërtetë,  
që veten rilind çdo pesëqind vjet!...

# Mali i Çikës

Nuk di se nga i ka mbetur ky emër:  
"Mali i Çikës".

Këtij mali majëborë ku gjëmojnë rrufetë,  
por di se ka edhe emrat "Vetëtima", "E prerë"  
dhe... lebër të pështetur rrëzë tyre!

Ndoshta këta emra i kanë lënë shekujt,  
për nder të njerzve  
ngaqë kështu u kanë qëndruar  
stuhive të jetës përherë:  
me çika,  
vetëtima  
dhe të prerë!...

# Ajkuna kërkon Omerin

Atë natë të rëndë rendnin të dyja;  
Nëna dhe hëna mes lugjesh me pyje.

Të dyja nëpër natën e thellë ngisnin,  
Njëra mes reve, tjetra mes lisash.

Të dyja përgjaknin flokët shtigjeve,  
Eposit legjendar me kuje të dridhëshme.

Me hapat e gjatë, të gjatë kilometër,  
Gjëmonin malet nga kujet për Omerin:

“O, Omeri im, Oi, oi...”  
Ajkuna çirr faqet dhe hëna mbante zi!...

Dhe era vajtonte, dhe era ulërinte,  
Veriu i egër yjet i ngrinte.

Të dyja rendnin në ankth, nën hënë,  
kërkonin Omerin e dashur, të rënë.

Kish rënë për nderin, kish rënë për tokën  
Një tis i përgjaktë spërkaste logun.



# Mesapl iku im

Një pyll njerëzish  
si një pyll lisash  
që gjelbërojnë vonë!...

Një det këngësh  
ku në to shkëlqen liria,  
një llavë shpirtërore  
ku thërret Shqipëria!

Malet dhe majat  
si kreshta mendimesh,  
hijerënda për historinë.

Buzë lumit - fushat,  
ku hareshëm lëvizja.  
Rrëzë maleve - fshatra,  
ku Shushica rrjedh  
si një ninullë e përjetshme!

# Shote Galicës

U bë nuse  
e, faqe të gjithëve  
burrin përqafoi.  
Në krahë të tij  
një jetë të tërë  
në male  
mes luftrash nusëroi!...

# Bjeshkët e namuna

Det pishash  
e ahesh shekullorë  
mbi të cilat lundrojnë  
vetëm anijet e shqipeve.

Kreshta malesh  
e majash kurorë  
që sytë lajnë  
me lot' të stuhive.

Përherë mbetën malësorët  
ballëdiell e borë  
që lirinë e kanë  
më të shtrenjtën e të gjithave.

Atëherë përse  
t'i kemi "nëmur" kështu ato?  
Ndoshta prej bukurisë  
së tyre të mahnitëshme!

# Mes pyllit me lisa

Degë-gjelbër, krahëpleksur,  
trungjegjerë ata janë  
Sikur fort me njëra-tjetrën  
kohët lidhur ata mbajnë.  
Pret sopata lëkurë lisi  
dhe prej saj një xixë del,  
Nga një plumb i egër kohe  
që nga lufta pati ngelë.  
Kuptoj luftën dhe të rënët  
nga xixa që sipër del  
dhe mendoj si fleta e gjelbër  
në kurorë nga plumbi çel.  
Shumë plumba kanë lisat  
nëpër trungje, veç blerimin  
S'e kanë humbur, s'e humbasin  
si dëshmia e kujtimit.  
Kujtoj luftën çlirimtare  
që ata mbrojtën aq jetë,  
Si u shkoi flakë e kuqe,  
flakë e kaltër nëpër degë...  
Tret vështrimin nëpër kohë  
ku nga spata xixa del,  
dhe mendoj se fletë e gjelbër  
në kurorë nga plumbi çel!...

# Flakë brezash

Si luani mu në ballë u vra Ziguri <sup>1</sup>  
dhe pas vdekjes bën me dorë nga flamuri!

Nëpër flakët e Çlirimit nip Avduli, <sup>2</sup>  
I ndrit pushka në betejë, i ndrit nuri!

Kur ra djali, habë Arifi vend i zuri, <sup>3</sup>  
vrau nazista... pushkë e tija male tundi.

Dhe Nurhana <sup>4</sup>, trimëresha, ligje thuri:  
- Djale e burrë, i kam gjallë tek flamuri! -

Dhe Shanikos, <sup>5</sup> nuses dritë, yllin i vuri,  
Atë yll që me gjak ndezi, trim Avduli!...

---

1. *Zigur Lelo* - Hero i Popullit, ra trimërisht në Luftën e Kotës kundër imperialistëve italianë, më 1920.

2. *Avdul Lelo* - Nipi i heroit, dëshmor i Luftës Antifashiste.

3. *Arifi* - djali i Zigur Lelos.

4. *Nurhana* - e shoqja e Arifit.

5. *Shanikoja* - nusja e Avdulit, doli partizane pas rënies së të shoqit në luftë.

# Çeta “plakë” e Vlorës

Asaj i vumë emrin “Plakë”  
Ç’metamorfozë e çuditëshme në flakë!  
Të gjithë partizanët ishin të rinj  
por kishin shekujt luftëtarë  
në gjak...

## Sulmi partizan mbi Krujë

Kur sulmuan partizanët garnizonin e Krujës,  
ku papushim qëllonin gjerman e tradhëtarë,  
ishte natë dhe hëna mbi malin e Skënderbeut  
ndriste si kurorë e artë lavdie...

E morën partizanët garnizonin e Krujës,  
dhe u thyen gjermanët si osmanët, dikur  
Gjergji shpatëzhveshur mbi kalin e bardhë  
Nga bregoria e hënës u buzëqeshte plot nur!

# Një shtëpi

*(Familjes Murraj nga Smokthina e cila i dha Shqipërisë katër dëshomrë)*

Një shtëpi u dogj nga lufta  
ajo luftën mbajti ndezur,  
djem e vajza luftëtarë  
me të ngrohur me të veshur;  
Natë e ditë dhimbje, gëzime  
mban në gji zjarr' i oxhakut,  
Flakë e ideal lirie  
ngroh dhe zemrën e njomzakut.  
Katër lastarë partizanë  
dolën dritë nga shtëpia,  
në fushën e nderit ranë  
me fjalën: "Rroftë Liria!"  
Çdo gjë dha shtëpizë e bukur  
në ato vite lirie,  
Dhe një ditë - ajo vetë  
u ndez flakadan lirie!



# Rexhep Qoses

Si dritë inxhie ndrijnë,  
mendimet për Shqipërinë!

Si shamia në një valle,  
ndriçon "Poezia e Madhe".

Flaka si dritë e qiririt,  
prerë nga drita e Naimit.

Sytë paqe, zjarr e bindje,  
Mjekra thellë në Rilindje.

Vepra - shatërvan i nderit,  
Feks me ngjyrat e ylberit.

Balli i gjerë, hark Kosove,  
yll' i kombit - djersë fitorje.

Pus' i dijes, trim mentar,  
Krenari për çdo shqiptar!...

# Dritëro Agollit

Ka diçka nga ylli i Naimit,  
Ka diçka nga drita e agimit.

Balli i menduar e floku i gjatë,  
Vargu i thelluar e rima e zjarrtë.

Dritëzojnë vargjet si kokrra vjeshte,  
Dritëzojnë shtigjet me motive vjershe.

Ecën i menduar e në ecje gjithmonë,  
Ky shterg madhështor i poezisë sonë.

Në çdo gjethëz e fletëz - fërgëllimë poezie,  
Drithërimë, përmallimë e frymë Shqipërie.

Lis madhështor epik në male,  
që përbuz dimrat, tallet me tufane.

Në emrin dhe mbiemrin e tij prej trimi,  
Ka diçka nga Drita dhe Agimi!



# Lirikë

Natira u vesh me gjelbërim anembanë,  
Zefir i maleve  
tund pyjet partizanë;;  
Unë i vura emrin  
djalit tim: BLERIM...

# Tronditje

Tronditem  
nga shkulmet çnjerëzore mbi planet,  
nga përplasja e tmerrshme  
e yjeve në galaktikë,  
por qetësohem  
nga drita e kaltër e dhomës sime të qetë,  
nga gjumi i qetë i gruas  
dhe i fëmijëve të mi sy-dritë!

# Burimet

Burimet rrjedhin me miliona  
nga gjinjtë e maleve me fletë,  
i mbajnë gjallë qëniet e gjalla  
dhe pllajën dhe luginën e blertë.

Ja një buzëshkëmbi e vogël si gota  
derdh ujin për njeriun vetë,  
buron, buron në mijëra epoka  
burimet rrjedhin përjetë!...

# Në takim të duarve

*E.*

Që në takimin tonë të parë  
zemrat na folën pa fjalë.  
Syri i dha syrit - një shikim të valë,  
Dora - dorës,  
një mesazh të bardhë!...

## Si Dea

... Kur arkeologët zbuluan Dean  
njëri-tjetrin panë të habitur në sy:  
Ç'penelë - daltë paska qënë ajo  
që ka lëmuar kështu një rreze - njëri?

Dhe ç'mjeshtër tokësorë paskan qënë ata  
që bojën e yllit të paskan hedhur mbi sy.  
O faqehënë, o borë e bardhë" -  
dhe merrnin dritë nga drita e tij.

Dhe provuan arkeologët t'i shkëputnin dritën  
dëborën e flokëve dhe kristalin në sy,  
por... s'ishte e mundur se pas perdes, errësirës...  
Dea depërtonte e bardhë, yllësi.

Ashtu edhe unë prej vitesh e vitesh  
provoj ta shkëpus kujtimin nga ti  
Por ti si Dea, në thellësi mendimesh  
më shfaqesh e bardhë, e bukur, yllësi...

# Perëndim dielli në Vlorë

Si një kokërr e stërmadhe, e artë,  
limoni në perëndim  
venit mbi valë  
fashat e tij të fundit  
dielli.

Vlorës sikur i thotë:

- Sa të marr një sy gjumë,  
farfurit ti  
midis tokës,  
detit  
dhe qiellit!...



## Një erë

Një erë e këndëshme manushaqesh vjen  
nga rrëzë përrallesh, nga çukat, nga brigjet,  
ndal i përgjëruar dhe kokën e kthej  
më deh erë e tyre në udhët e shtigjet.

O pranverë, e bukura pranverë,  
e veshura me diell, me zile në maja,  
Ç'ma merr zemrën time kështu, ç'ma merr,  
si një zok krahëshkruar ma shpie në pllaja.

Si çobani me culë luleve t'u flas  
mes pyjesh me lisa të më zerë gjumi,  
lëndinash me diell të muajit mars  
të dehem nga kjo botë e gjerë parfumi!...

# Jezu Krishti

Ku është?  
Në qiell,  
në dete,  
në tokë,  
nën tokë?!  
Asgjékundi dhe kudo:  
i pastër si qielli,  
i kaltër si deti,  
i vetësakrifikuar  
me frymë profeti  
si trupëzim i dritës  
në gjirin e planetit!

## Çast

Ishte dimër, ndriste bora, ajo vinte  
gushëbardha posi hëna vetëtinte.

I kish dhënë fjalën djalit e s'duronte,  
s'e desh jetën me një tjetër që s'e donte.

E prit djali zemërndeaur aqë shumë,  
dashuri e tyre e thellë si një lumë.

Perde bore përmbi brigje, hëna ndriste,  
përmbi borë gushëhënë ajo vinte.

Asgjësendi rreth'e rrotull s'pipëtinte,  
veç rrëkeza nëpër gurë shushurinte...

Gushëbardha përmbi gurë seç po vinte,  
mbi rrëkezë copa-copa dora shkrinte!...

# Rudhat

Na lëroi ballin plugu i varfërisë  
Mendimet na i trishtoi,  
I dha djalit rudhat e pleqërisë  
Fytyrën lule ia shëmtoi.

“Dalohen nga rudhat shqipëtarët, - thotë  
Çdo emigrant që ka punuar nëpër botë,  
More, po vetëm këtu paska bërë gropë  
Kjo varfëri mort?!

Kjo varfëri - mort!...

# Sevelim

(Poetit të madh turk Jonus Emresë)

Vargjet-qiell, agim me zefir  
në lëndinat turke, në Eskishehir.  
Rrëzojnë, drithërojnë aromë trëndafili,  
vargjeve në shekuj s'u humbi gjelbërimi.  
Trëndafilë divanesh, kandilë të ndezur,  
pëllumba të shpirtit, përherë të çelur.  
Homeri poezinë pikoi në botë  
tek Jonuzi, Sadiu <sup>1</sup> dhe bardët e ngrohtë.  
Pikojnë vargjet: "Sevelim, Sevelim" <sup>2</sup>  
Tek Naimi i madh, tek bardhi Selim. <sup>3</sup>  
"Sevelim" - jehona e një kreshte mali,  
pesëqind e ca vjet ushtim ideali.  
Ushtojnë divanet e Jonuz Emresë,  
jehonën ia kthen shkëmbi Edrenesë.  
Vargjet-qiell, agim me zefir,  
në lëndinat turke, në Eskishehir!...

- 
1. *Sevilim* - paqe, dashuri mes njerzve.
  2. *Sadiu* - poet i shquar persian.
  3. *Selim Hasani* - këngëtar popullor nga Brataj.

## Hëna

Një rreze shket mbi fletë  
një bredh tund krahët në hije,  
një lule puthet nga një bletë  
fëshfërin një degëz lajthie.

Pas pak mbi mal del hëna  
e bardhë, e plotpushtetshme,  
gjithçka e lan në argjënd,  
vajzë - fotomodele e përjetshme!

## Ajo vajzë

Mbi ballë ka lidhur hënën,  
në flokë ka lidhur rrezet,  
mbi flokë ka lidhur ylberin.  
Në faqe ka lidhur, mollët,  
në sy ka lidhur yjet,  
në buzë ka lidhur qershitë.  
Çfarë është?  
Njeri,  
lule,  
pemë  
apo dritë?!...

# Flokët e asaj vajze

Flokët e asaj vajze  
janë udhë  
për në petalet e zemrës,  
janë pentagrame  
për në trenin e këngës,  
janë rreze  
për në plazhet e ëndrrës.  
Por mund të jenë  
edhe buzëbrisku  
për në honet e gjëmës!...



# Mall

*(Shokut tim A.1)*

Kam mall për shokët e djeshëm  
ata që në ballë kishin bukuri,  
kam mall për rinin e hareshme  
që na fali djersë e burrëri...!

## Një rreze

Më erdhi një rreze drejt e më gëzoi  
e në zemër më çeli frymëzim,  
pastaj rrezja iku  
pas një reje qëndroi,  
e mua më mbushi trishtim.  
Rrezja nga reja  
prapë mund të dalë,  
po atë frymëzim  
në zemër a mund të ma ngjallë?!

## Shije

E urrejt kohën e squllët  
me shira të plogët,  
katranin e reve  
që nxijnë nga poshtë;  
Pëlqej,  
ose kupën e qiellit  
me yje të plotë,  
ose shiun e rrëmetshëm  
prej nga s'del jashtë dot!...

## E bukur

E bukur është lëkundja e barit nga era,  
Fërgëllim i fletëve të verdha që këputen.  
Por më i bukur është qëndrimi i bredhit  
që s'këputet si fletët, por qëndron i patundur.

I bukur është deti i filizave  
i luleve, i barit apo i grurit të artë,  
por më e bukur është kurora e lisave  
që vonojnë,  
por ruajnë pranverën më gjatë!

# Lasgush Poradecit

- Kush me lirika liqenin e mbushi?  
Ai ishte Lasgushi!
- Kush i pati lirikat si ari?  
Ai ish Llazari!
- Kush vetes i dha emër qyteti?  
Lasgush Poradeci!
- Kush i këndoi si askush dashurisë?  
Lasgushi i Shqipërisë!

# Babai

Në supet e tij  
pelerinë pranvere.

Xhaketa e tij  
si ugarë filizash.

Pëllëmbët e tij  
me brazda blërimi.

Hapat e tij  
mërmërinë vitesh.

Stinëve të jetës  
ua dinte sekretin.

Djersa ia bënte  
mendimin të paqme.

Gjoksi i tij  
i trembte dimrat.

I la të nesërmes  
sytë e qeshur!...

# Mëngjez Myzeqeje

Fusha - e përgjumur  
nën vello brazime.

Mullarët - meditues:  
"Ç'të bëjmë me të ardhmen?!"

Disa selvi të rralla  
kërkojnë fenë e mërguar.

Shtëpi e fshatra të tëra  
nën mjegull ëndërash..

Dielli del  
e u shkrin brazimën...

# Përpara portretit të De Radës

Sytë të tretur  
nga malli i Arbërisë,  
Nofulla të futura  
nga merakuri i largësisë,  
Buzë të mekura  
nga loti i dashurisë  
Mishrat të holluar  
nga erozioni i pleqërisë!

Tani thotë:  
“Sikur edhe vetëm kockat të më mbeten,  
do t’i zvarrit ato  
drejt Shqipërisë!”.



## Dëshirë

T'i njihja gjithë lulet emër për emër,  
Të emërtoja kështu krejt livadhin e gjelbër!

Ta lexoja livadhin, si libër ta ktheja,  
çdo faqe me lule dhe aroma të reja.

Me pamje të tjera, e të tjera ngjyra,  
që i stolis me ankth dor' e mëmës, natyra.

E kështu mes lulesh doja pa mbarim,  
të endej e të tretej përjetë shpirti im.

Sepse në zemër më ndrit një livadh me lule,  
që zemrave dua t'ua jap me tinguj cule!...

## Udhëtoj me stinët

Udhëtoj me lumin e gjelbër të pranverës,  
Udhëtoj me tharjen-çokollatë të verës,  
Udhëtoj me zhveshjen e verdhë të vjeshtës  
udhëtoj me bardhësinë e acartë të dimrit.  
Udhëtoj me to dhe u marr ngjyrat,  
në zemër, në sy më regëtojnë pasqyrat!...

# Lëviz gjithshka

Lëviz ylli i bardhë  
në çipë të mëngjesit,  
e verdha ngjyrë e vjeshtës  
në fletë të pemëve lëviz,  
lëviz qetësisht kup' e qiellit  
në lot të vesës  
lumi i gjelbër i jetës  
shkon dhe në një filiz...

## Natyrë e qetë

Buzëqeshja e yjeve  
në mugëtirën e qetë,  
dremitja e pyllit me lisa  
ku s'leviz asnjë fletë,  
një livadh me lule  
ku zukat një bletë,  
dy palë sy  
që shikohen me et',  
dy njerëz nën hënë  
që shkrihen në një siluetë!...

# Muajt dhe ngjyrat

Kur nis gjelbërimi  
Marsi i shkretë,  
hedh supit filizat  
pelerinën e blertë.

Prilli dhe Maji  
princa bukurie,  
bashkojnë të gjelbërën  
me të kaltrit qiej.

Më pas Qershori  
deri në Gusht,  
me bojën e kaltër  
krejt detin e mbush.

Shtator-Tetori,  
e gjer në Nëntor,  
ylberin Vjeshtës  
i derdhin me dorë.

Dhjetor-Janari  
e shkurti më pas,  
çarçafin e bardhë  
të borës lënë pas.

Vjen koha çdo muaj  
ngjyrën e ndez,  
flamurin e stinës  
në univers!...

## Gruri

Dorë e punës e ka çelur  
zgjuar farën aq mirë,  
sa filizat në çdo cep  
majë gurit kanë mbirë!...

Jeshilon e tund filizat  
nëpër diell arë e grurit,  
sa krejt fushëza e gjelbër  
i ngjan palës së flamurit.

# Tirana pas emigracionit

Blirët pikojnë blozë nëpër degë,  
mbi rrugë re pluhuri,  
nën vjeshtën blu;  
megjithse njerëzit s'ështënin, prapë  
qielli të duket si humnerë  
rrugicat, lulet, sheshet gjithashtu!

Ç'u ka ndodhur trotuareve, pistave  
mijëra llampave të zbehta mbrëmësore,  
ç'u ka ngjarë?!  
Ajo që njerëzve u ka munguar, ikja,  
Ajo që duhej filluar pesëdhjet' vjet më parë!



# Shtëpia e një emigranti

Shtëpia-vetëm.  
Perdet në dritare  
të rëna.  
Gjitoni herë pas here  
lë dritat ndezur aty.  
Brënda muret  
me një heshtim dëbore.  
Mbi sendet  
një pluhur vetmie.  
Dy mace  
vështrojnë të trishtuara,  
nga kalendari i zverdhur.  
Ora e murit  
ka ngecur  
në shtatë pa njëzetë.  
Një polifoto nga muri  
flet për të shkuarën,  
oh, sa e ka zgjatur largësinë!  
Lulet në saksi, të vyshkura,  
në një monolog memec.  
Pjatat në një kënd  
presin amvisën.  
..Dhe gjithshka aty brenda  
pret kthimin e të zotërve!...

# Ajo iku...

Ajo iku

(Nuk dihet se si...)

një mëngjes të vrejtur!

Në boçe kishte rrobat

(të paktat rroba)

si pelena të jetës.

Në rrugë ngadalësoi hapin

me grushtin tek loti.

Për kë të çante?

Për ngurtësinë e babait?

Për sytë e vrëngër të vëllait?

Për lotin e fshehur të nënës?

Apo për sytë e kaltër

të motrës miturake?!...

Një mirupafshim u la të gjithëve

edhe qenit, edhe maceve,

perdeve në dritare,

lehës me lule të fëmijërisë,

mureve të bardha atësore,

shtëpisë...

Mirupafshim! - dhe iku.  
Iku me njërin sy pas,  
me mërmërimë hapash të trishtuar.  
Koha ishte e vrenjtur,  
dita nxinte.  
Në dorë,  
ajo mbante një boçe të lehtë rrobash  
si pëlena të jetës!...

# Çamëri pellg i dhimbjes

*(Duke parë ekspozitën fotografike të S. Beqirit)*

Gjithçka aty brenda  
gjëmon.  
Gjithë ulërimat e thekshme  
të dramës.  
Gra me sy të errur tmerri  
për burrat e therur.  
Ato-duarlidhura  
jetës ç'ti japin?!  
Fëmijë  
me zemra e koka të ngjeshura  
urie e ere.  
Vasha  
(Oh! Yllesat shqiptare!)  
në radhë për një copë bukë!  
Një plak  
vdekur pranë një ulliri  
sytë e tij të hirtë  
vallë hënës ç'i thonë?!  
Një magnetofon diku  
shpërndan sinfoninë e dhjetë çame.

Toka lëkundet ende  
nga valët e gjakut  
nga rradhët e dhimbjes.  
Djali i Skënder Beqirit  
puth muret e shtëpisë  
pas pesëdhjetë vjetësh në Çamëri.  
Gurët aty s'janë  
veçse lotët e ngrirë të çamëve.  
Mbi gërmadhat enden  
legjendat e Çamërisë.  
Motër Çamëri,  
gjër kur do të shohim  
vetëm në fotografi?  
Çamëri-Historinë shovene.  
Çamëri-dy herë Bosnje,  
retrospektivë e shekullit!

# Viti Qen

1913-ta qen  
kafshoi kombin në mes.  
Ndau  
gjysmën e dheut,  
gjysmën e gjuhës,  
gjysmën e gjakut,  
gjysmën e qiellit.

Prej njëqind vjetësh  
borë urrejtjeje,  
stuhi vullkani,  
stinë tërmetesh.

Gjaku pikon  
nga thelbi i zemrës.  
Loti pikon  
nga syri i diellit,  
po shpresa ndrit  
në kupë të qiellit!...

# Kohët e kombit tim

Si i ndau kështu  
kohët e kombit tim  
natyra mëmë  
kështu, si?!  
Të shkuara në varg  
pambarim,  
si sumbullat në tespi.  
Të shumtat të zeza  
si dënese,  
po me jetë,-  
shkurtësi,  
të bardhat të pakta  
si urata,  
po me pa-  
vdekësi!...

# Zhgënjimi i bajames

U zhgënjeve bajame, u zhgënjeve  
nga dielli që çau mes reve.

Të çelën lulet me buzët e erës,  
mbi ty fustan i ri pranverës.

Po erdhi ngrica e pabesë  
dhe filloi lulet t'i zhveshë.

Të mblodhi papritur zhgënjimi,  
në pelerinën e hirtë të dimrit.

Gjersa lulet t'i riçelësh një ditë,  
si flakë rozë a si dritë.

U gënjeve, bajame, u gënjeve,  
si vajzat nga dielli i djemve...



## Peisazh me mollë

Një dyqan në rrugë  
me tavolinat, arkat, raftet  
plot me mollë.

Midis tyre  
një vajzë  
me dy mollët e gjoksit  
nën fustanin e hollë  
shet mollë...

## **Pak mister**

Dhe kumbulla në lulëzim,  
dhe vajza në nusërim,  
e kanë pak mister.  
Dhe kënga natën vonë,  
dhe puthja nën neon,  
e kanë pak mister.  
Dhe vesa në agim,  
dhe loti në trishtim,  
e kanë pak mister.  
Dhe deti pa kufi,  
dhe drita në liri,  
e kanë pak mister!

# Romantikë

Një mështek në ngarkuar me dëborë  
si nuse me vello, kurorë...

Një lëndinë deti magjik,  
me pafundësinë muzikë.

Një çift përdëllimtar nën hënë,  
një mesazh i heshtur më këmbë.

Një qylym me lule malore,  
jehonë e botës dashurore.

Një lis i vetmuar në shpat,  
tragjik nën yjet e lartë.

Një mal si hije në largësi,  
si hark mendimi, përjetësi.

Dielli në gjak të perëndimit,  
sy i kuq i trishtimit.

Kalorës që erdhën në agim,  
humbasin buzë mbrëmjes pa kthim!...

# Puna zgjon kohën

Eshtë kohë e fjetur,  
vetëm duke e soditur dashurinë.  
Eshtë kohë e fjetur,  
vetëm duke e përkëdhelur fatin.  
Eshtë kohë e fjetur,  
vetëm duke e ëndërruar lumturinë.  
Kështu koha vdes  
dhe atë e rizgjon  
vetëm puna  
që e bën atë të ziejë  
me zëra dhe fruta të bukura!

# Motive nga Greqia

Ku janë mitet e famëshme, ku?  
Si dymijë ishujt nëpër Egjeun blu?!

Perënditë e tmerrshme të qiellit ku janë,  
që zotëronin tokën dhe detin pa anë?!

Ato s'janë më tek Olimpi në qiell,  
perëndi janë burrat dhe gratë nën diell!

Si thikë zbret mbi det mali,  
me shtatë ngjyra feks edhe përralli!

Të gjitha jetët këtu me një shëndet të plotë,  
zemra një këngë Elladhe më thotë...

Selvitë të nxira nga misteri e koha,  
karakolle të një feje të vjetër sa bota.

Si nimfa moderne atje në Livadhja,  
flokëvalvitura vajzat me këna...

E vjetra qëndron mbi fragmente muri,  
mbi kështjella vallëzon vijakaltri flamuri.

Djersa nga puna për vete shkëlqen,  
në rrugët, në vilat, për vajza, për djem.

Të gjitha jetët në lulëzim të plotë,  
zemra një këngë Elladhe më thotë...

**1994**

# Peisazhe

1

Pishat epike  
kanë zbritur mbi valë,  
si për t'i shuar  
malit mallë...

2

Një vajzë e një djalë  
puthen mes hiresh,  
një neon u bën  
dritë midis bliresh!...

# Fjalët shqip

Janë bijëza të trungut të vjetër  
këto luleza

si prushe yjesh të egër.

Në Qirjakat <sup>1</sup>

dëgjova një plakë,

që lëçiste shqipen

si në Vlorë a Filat!...

Në Zeriç <sup>1</sup>

një plak më tha:

- Gjithe shqipëtarë jemi! -

E zemra m;u bë mal i Çipinit.

Këto lulesa të brishta kohe

me aromë lulësh ndër mote.

Kjo farë e dheut mëmë

me lastarë, degë e rrënjë...

Vehten e ndjej

mes arvanitasve

si në një fole stërgjyshore!

Ata kënaqen kur u them:

- Ena gluhë, ena ema!...- <sup>2</sup>

---

1. Qirjakat dhe Zeriç - fshatra arvanite në rrethinat e Athinës.

2. Një gjuhë, një gjak.



# Shkurtima

1

I kaltër, i thellë je, o det gjithkund,  
po më të thellë janë sytë e mi,  
se brenda tyre mbajnë  
një shpirt të pafund!...

2

Në preher harkmalesh  
perla Vlorë,  
Karaburuni zgjatet,  
të prek me dorë!

3

Sazani trupvogël  
i imtë si djalë,  
për të lozur  
në fushën e detit ka dalë...

4

O det, si lule mbi valë  
ta hodha fjalën,  
e ti, si peng në shpirt  
më dhe dallgën!...

# Panteizmi i Naimit

Perëndia në çdo lule, në çdo pemë, në çdo bar.  
Tek burimi, tek një rreze, tek filizi në ugar.

Tek njeriu, gjithësia, tek çdo gjë që ndrit në botë,  
Tek çdo qenie e gjallë si në det edhe në tokë.

Ajo është brenda nesh e kudo rrotull n'eter,  
Në çdo grimcë të universit dritë e kaltër frymë merr.

Aty ku shpërthen filizi që nga kokrr' e dheut del,  
Aty uratë e bekuar, shenjtëria zemrën çel.

Eshtë vetë e njëjtësuar ajo rreze me natyrë,  
Me çdo gjë që ka një emër, ka një dritë, një fytyrë.

Dritë e saj në zemrat tona pluhur jete është shkrirë,  
dhe rreh botën që ta bëjë më të bukur, më të mirë.

Dhe së fundi, në Atdheun tonë të dashur Shqipëri.  
Ka një frymë, ka një etje, brënda saj një perëndi.

# Trishtim i verdhë

Retë filluan shtegëtimin  
kaltërsia e verës shkoi,  
Balozi i bardhë dimër  
shtërngatat me heshta afroi.

Trishtim i verdhë mbi fletë  
si re mbi pyllnajën e gjerë,  
qëndron disa kohë gjersa zbret  
në tokën e hirtë i tërë.

E verdha ngjyrë e bukur e vjeshtës  
midis dy botëve kufiri,  
si pezëm midis së katrës, së gjelbrës  
dhe së bardhës së acartë të thellimit.


Pyllnajat e verdha kudo  
lëshojnë fletët, vathët e gjelbërimin,  
gjersa natyra e zhveshur nudo  
i dorëzohet në heshtje dimrit!...

# Mendimet

Natë e ditë më bluajnë mendimet  
për lumturinë e jetës, fëmijët, artin;  
por ç'e do, detyrohem nga mjerimi  
të marr rrugën e emigrantit.

Gjysma e jetës më kaloi në terr,  
rinia e bukur-flutur,  
tani mendimet më pikojnë vrer  
për kohën e artë, të humbur...

Mendimet, të lodhura më shkojnë kudo,  
në sfera të jetës, në politikë;  
veç përherë më rri ndezur përmbi to  
shqetësimi i këndshëm poetik...




# Përmbajtja

Mbijetesë .....	5
Mali i Çikës .....	6
Ajkuna kërkon Omerin .....	7
Mesaplaku im .....	8
Shote Galicës .....	9
Bjeshkët e namuna .....	10
Mes pyllit me lisa .....	11
Flakë brezash .....	12
Çeta "Plakë e Vlorës .....	13
Sulmi Partizan mbi Krujë .....	14
Një shtëpi .....	15
Rexhep Qoses .....	16
Dritëro Agollit .....	17
Lirikë .....	18
Tronditje .....	19
Burimet .....	20
Në takim të duarve .....	21
Si Dea .....	22
Perëndim dielli në Vlorë .....	23

Një erë .....	24
Jezu Krishti .....	25
Çast .....	26
Rudhat .....	27
Sevelim .....	28
Hëna .....	29
Ajo vajzë .....	30
Flokët e asaj vajze.....	31
Mall .....	32
Një rreze .....	33
Shije .....	34
E bukur .....	35
Lasgush Poradecit .....	36
Babai .....	37
Mëngjez Myzeqeje .....	38
Përpara portretit të De Radës .....	39
Dëshirë .....	40
Udhëtoj me stinët .....	41
Lëviz gjithçka .....	42
Natyrë e qetë .....	43
Muajt dhe ngjyrat .....	44
rruri .....	45

Tirana pas emigracionit .....	46
Shtëpia e një emigranti .....	48
Ajo iku.....	49
Çamëri pellg i dhimbjes .....	50
Viti qen .....	51
Kohët e kombit tim .....	53
Zhënjimi i bajames .....	55
Peisazh me mollë .....	56
Pak mister .....	57
Romantikë .....	58
Puna zgjon kohën .....	59
Motive nga Greqia .....	60
Peisazhe .....	61
Fjalët shqip .....	62
Shkurtima .....	64
Mendimet .....	65
Përmbajtja.....	67





## *Ndreqje gabimesh*

<i>Fq.</i>	<i>Është</i>	<i>Duhet</i>
7	nën hënë	nënë e hënë
8	ku hareshëm	ku zjen hareshëm
14	bregoria	breroria
16	"Poezia e madhe"	"Porosia e Madhe"
26	dora	bora
27	... gropë	kaq gropë
28	rrëzojmë	rrezojnë
51	Historinë moderne	Hiroshimë moderne